- 1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;
- 1.3. mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

KREU X

MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

Neni 34

Mbikëqyrja inspektive

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t'i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësive të veta.
5. Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

Neni 35

Inspektimi jashtë territorit të komunës

Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjinden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 36

Kundërvajtjet

1. Në territorin e Komunës së Vitisë, për mosrespektim të dispozitave të Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina, dhe sipas gjobave të përcaktuara në këto nene, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara në këto nene personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës të personave juridik.
2. Veprimet e ndaluar dhe gjobat sipas paragrafit 1 të këtij neni janë të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 37

Procedurat e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

Neni 38

Veprat penale

Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

Neni 39

Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur

1. Për tërë mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave, përgjigjet hedhësi i tyre.
2. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, ne pajtim me përgjegjësitë ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë Komuna, e cila siguron largimin e tyre.

KAPITULLI XI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 41

Procedura përmbartimore dhe gjyqësore

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë procedurë përmbartimore dhe gjyqësore nga njësitë përkatëse të komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Buxhetimi

1. Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.
3. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët.
4. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
5. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 43

Regjistri i deponive ilegale

Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Vitisë, sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.

Neni 44

Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

Neni 45

Zbatimi

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Vitisë i nënshtrohen:
 - 1.1. SMM si dhe organet dhe administrata komunale;
 - 1.2. Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.3. të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;
 - 1.4. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve publike dhe/apo udhëheqësit të SMM.
3. Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësiive përkatëse.
4. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.
5. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 46

Interpretimi i Rregullores

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutë, Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Ligjit për mbeturina, dhe Statutit të Komunës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërtënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

Neni 47
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Nr.01-110/05-752 datë 30.07.2020 (*NË RASTET KUR KA NJË RREGULLORE TË TILLË*)

Neni 48
Publikimi

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në "Gazetën Zyrtare".

Neni 49
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.
3. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.

Kryetari i Komunës

/ Sokol Haliti



**PIKA E KATËRT E RENDIT TË
DITË**



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilloga Më/Dana: 13-04-2023

Nr. i organit Org. broj	Numri/Straj	Shënues Prilog	Vlera Vrednost
02-035	02-314		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Vitina

Në mbështetje të dispozitave të nenit 17 paragrafi (f), neni 28, 29 të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje lokale (GZRK Nr. 28/2008), lidhur me nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-040 për Bashkëpunim ndërkomunal, dhe neni 50, shkronja l e Statutit të Komunës së Vitisë, nr.01-0113/491 te dt.2104.2011 Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë , propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miatimin e iniciatives për Bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet Komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të integruar të mbeturinave

1

Me këtë propozim vendim të bëhet miratimi iniciatives për Bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të integruar të mbeturinave.

2

Bashkëpunim ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave:

- 2.1 Komuna e Gjilanit;
- 2.2 Komuna e Ferizajit;
- 2.3 Komuna e Kamenicës;
- 2.4 Komuna e Vitisë;
- 2.5 Komuna e Kaçanikut;
- 2.6 Komuna e Hanit të Elezit;
- 2.7 Komuna e Shimes;
- 2.8 Komuna e Shtërpcës;
- 2.9 Komuna e Kllkotit;
- 2.10 Komuna e Ranillikut;
- 2.11 Komuna e Novobërdës.

3

Kryetari i Komunës dhe Ekipi ndërkomunal (themeluar nga Kryetari me nr. 02-035/02-861) janë të autorizuar të iniciojnë dialogun dhe të punojnë së bashku në hartimin e Planit të integruar ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të indentifikojnë implikimet e mundshme financiare duke përfshirë burimet financimit për zbatimin e duhur të planit. Kryetari i Komunës dhe ekipi ekzistues ndër-komunal mund të indentifikojnë gjithashtu implikime tjera të mundshme në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

4

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Kerkesa e Kryetarit të Komunës së Vitisë e arsyetuar, për miratimin e iniciativës për bashkëpunimin ndërkomunal ndërmjet komunave përkaëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

5

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë si dhe mekanizmat tjarë relevantë.

Propozuesi:

Drejtori:

/ Basri Aliu /

Kryetari i Komunës:

/ Sokol Haliti /





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Vitina

DATE/A	13.04.2023
REFERENCË	
PËR (ZA) TO	Kryetarin e Kuvendit të Komunës së Vitisë ,Bekim Azizi
CC:	
PËRMES(PREKO)THROUGH	
NGA (OD) FROM	z. Zyrën e Kryetarit të Komunës së Vitisë –Sokol Haliti
TEMA (SUBJEKAT) SUBJECT	Kërkesë për miratimin e iniciatves për Bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të integruar të mbeturinave

I nderuari Kryetar i kuvendit të komunës së Vitisë, kërkesa për miratim të iniciatves për Bashkëpunim ndër-komunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të integruar të mbeturinave është qëllimi i bashkëpunimit ndër-komunal është përimisimi i sektorit të menaxhimit të mbeturinave me komunitat tjera të regjionit të anamoravës përmes qasjes së menaxhimit të integruar të mbeturinave. Bashkëpunimi do të bëhet në bazë të reciprocitetit me qëllim që të ofrojë përfitime reciproke ndërmjet komunave në mbrojtjen e interesit të pergjitheshëm publike në mbrojtjen e ambientit.

Bashkëpunimi ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave krijon bazë për zbatimin e sistemit regional, në pajtueshmeri me parimet themelore për menxhimin e mbeturinave të përcaktuar në deriktivat e BE-së dhe në ligjin për mbeturina në lidhje në sektorin e menaxhimin e mbeturinave.

Me respekt,

Viti, më dt. 13.04.2023

PIKA E PESTË E RENDIT TË DITË



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranor - Prilazja Nöndërgj. 13.04.2023

NR. ORDENIT Org. nr. 02	Numri/Straj	Shprehja P. Nr. 02-035/02-311	Vista Vite/na
----------------------------	-------------	----------------------------------	------------------



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, pika h, neni 30, paragrafi 1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në neni 18 të Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, bazuar në nenin 6 të Rregullores për Procedurat e Bashkëpunimit Ndërkombëtarë Nr. 0208-1334, e datës 18.12.2012, neni 50, paragrafi 50.1, pika l të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain – Gjermani

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të bënë miratimin e marrëveshjes për binjakëzimin mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain – Gjermani.

Neni 2

Në kuadër të marrëveshjes së cekur në neni 1 të këtij propozim vendimi, do të themelohet bashkëpunimi në fushat e përcaktuara në marrëveshjen e arritur në mese të dy palëve.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Marrëveshja për Binjakëzimin mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain me Nr.02-035/02-309, e datës 12.04.2023.

Neni 4


Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti





Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, bazuar në neni 18 të Ligjit për Nr.04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal, bazuar në vendimin për bashkëpunim ndërkombëtar të qëndrueshëm me komunën e Kirrhainit vendimin me nr. 01-110/05-96 i datës 01-02-2019, vendimin për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Kirrhainit –Gjerman, vendimin me nr. 01-110/05-210 i datës 04.03.2019, vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirrhainit, vendimi me nr. 01-110/05-209 i datës 04.03.2019, lidhur me nenin 50 shkronja I të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë dhe Kryetari i komunës së Kirrhainit-Gjermani miratuan këtë;

MARRVESHJE E BINJAKZIMIT KOMUNA E VITISË ME KOMUNENE E KIRCHHAIN – GJERMANI

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja e binjakëzimit të komunës së Vitisë me komunën e Kirrhain ka për qëllim bashkëpunimin ndërkombëtar të qëndrueshëm ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirrhain-Gjermani të cilat janë në fushën e partneritetit të qëndrueshme në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

Neni 2

Lënda e marrëveshjes

Në kuadër të këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, do të realizohen objektivat e parapara në kuadër të Agjendës 2020-2030 në përmbushjen e 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG's).

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Me këtë marrëveshje komunat zotohen se do të bashkëpunojnë në fushat:

- a) Hulimtimi, inicimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta në zhvillimi ekonomik
- b) Hulimtimi, inicimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta në mjedisin dhe mbrojtjen e mjedisit
- c) Shkëmbimi i përvojave në fushën e zhvillimit të bujqësisë
- d) Menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi dhe mbrojtja nga përmytjet
- e) Fusha të tjera që janë në interes të qytetarëve të të dyve komunat përkatëse.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në marrëveshje

Palët deklarojnë se kanë lexuar me kujdes dhe e kuptojnë në tërësi marrëveshjen e binjakëzimit dhe pajtohen që pa rezervë t'i pranojnë obligimet që dalin nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Detyrimet të tjera

Palët do të marrin masa e nevojshme për të realizuar veprimtarin në të gjitha fazat e realizimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimin e akteve të tjera pasuese që dalin nga ky bashkëpunim i ndërsjellët në lidhje me bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar.

Neni 6

Dispozitat e përfundimtare


Kjo marrëveshje hyn fuqi në momentin e nënshkrimit të palëve, kjo marrëveshje mundet të plotësohet, ndryshohet dhe shkëputet me pëlqimin e ndërsjellët të tyre

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptimin mes palëve.

Kjo marrëveshje është i lidhur në gjashtë kopje identike prej të cilave secila palë e mbanë nga (3) kopje.


Kryetari i komunës se Kirchhain

z.Olaf Hausmann



Kryetari i komunës se Vitisë

z.Sokol Haliti



**PIKA E GJASHTË E RENDIT TË
DITË**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogur Mbrojtës <i>13-04-2023</i>			
Nr. organit Org. broj	Numbri/Drej	Shtetësi Prilog	Vlera Vendosje
<i>02-035/02-312</i>			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 50 paragrafi 1 pika l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të dates 21.04.2011, në harmoni me dispozitat ligjore të Rregullorës QRK Nr.22/2020 për Rintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregullorën për Integrimin e të huajve QRK Nr.09/2019, Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që ja lejon ligji paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Planin Komunal për Rintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vitisë 2023-2025

Neni I

Me këtë propozim vendim kryetari i Komunës propozon Për Planin Komunal për Rintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vitisë 2023-2025.

Neni II

Qëllimi i këtij propozim vendimi është riintegrimi i qëndrushëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmisimit të vazhdueshëm të një sistemi efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Neni III

Ky plan përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, koston financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët mates dhe mjetet e verifikimit.


Neni IV

Ky propozim vendim hynë fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues, Kryetari i Komunës

Z. Sokol Haliti





Komuna Viti
Opština Vitina

PLANI KOMUNAL PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHSUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E VITISË
2023 - 2025

**Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e V
2023 - 2025**

Shkurtesat

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APRK	Ajensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës
AZHBR	Ajencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Ri integrim të Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPPRM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korriza Afatnesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Ri integrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
NMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Martëveshja e Stabilizim Associmit
PR	Person i Riadhesuar
PIR	Plani Individual i Ri integrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimi Profesional
QPS	Qendrat për Pune Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Rinintegrimin e personave të Riadhesuar si dhe bënë Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendim nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimit dhe Ri integrimi tashmë përmblusur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riadhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm i sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Mingrim 2022 - 2025, Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Vitisë.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektivat saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përfaqësuar për zhvillimin e aktiviteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteve dhe rrethet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Rinintegrimin e personave të Riadhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendim nr. 01/110, date 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPP/DRPRIH si institucion përgjegjës i integrimin në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riadhesuar në Komunitet e Vitisë përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Këshillat, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riadhesuar integrimin e të huajve në komunën e Vitisë.

Plani Komunal i Veprimt për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2023-2025

Objekti i 1:		Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit		Baza	Caku 2023	2025		
<i>Avancimi i sistemit të ri integrimi për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve</i>		<ul style="list-style-type: none"> Pasi të janë identifikuar nevojat e grupeve të ceneshme shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimi dhe te integrimi; Shërbimet e riintegrimi dhe integrimi monitorohen sistematikisht dhe ndërmerrin masat e nevojshme përmirësuese; Është arritur riintegrimi dhe i integrimi qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të ceneshme; 		40%	60%	80		
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikim
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të ceneshme;	1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyer, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas martes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS;	NR. i familjeve të ceneshme të kthyer, dhe të huaja në komunë Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN Nr. i FVN të plotësuar	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia në komunitet - (Sipas nevojës)	KA	Në vazhdimësi	Raport tere FVN i p dhe nën nga p SM
		2. Intervistat familjen dhe plotëso formularin e Vlerësimit të Nevojave;	Nr. i formularëve të vendosur në SMR		Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			

		3. Vendos FVN të skanuar në SMR								
1.2	Hartimi i planit individual të ri integrimi dhe integrimi, bazuar në pakot standarde të shërbyeve dhe nevojat e identifikuar ne FVN;	Harto Planin Individual të ri integrimi dhe integrimi për secilin person dhe familje të ceneshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale;	Nr. i Planeve Individuale të ri integrimi dhe integrimi, të hartuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi		F Indiv ri inte integ S	
1.3	Zbatimi i planit individual të ri integrimi dhe integrimi përmes ofrimit i shërbyeve të ri integrimi të qëndrueshëm për grupet e ceneshme;	Këshillo personin e riadhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informoje për afatet ligjore të parashtrimit të kërkesave; Ndlumo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpunu me drejtoritë përkatëse komunale për sigurimin e shërbyeve të nevojshme; Regjistro kërkesat dhe përfitimet në	Nr. i kërkesave të parashtruara, bazuar në PIR; Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes; Nr. i kërkesave dhe përfimeve të regjistruara ne SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse ZP QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i ri integrimi dhe integrimi	Në vazhdimësi	Rap rreg Kërka parash SN		

1.4	Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ri integrimi dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e ceneshme;	SMR; Monitoro në baza mujore zbatimin e PIR;	Nr. i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rritjeve dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raj trem monit vler
1.5	Vlerësimi përfundimtar i ri integrimi dhe integrimit të mbyllja e rasti;	Vlerëso gjendjen përfundimtare dhe nivelin e ri integrimi dhe integrimit te PR sipas PIR; Mbylle rastin në dokumentacion fizik; Mbyll rastin në SMR- konstat - ri integrim / integrim i qëndrueshëm;	Nr. i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike SMR	ZKKK DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rritjeve dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Rapo mbyll rasteve muq Dosjet fi PR, të m SM	
Objektivi specifiku: 2		Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit		Baza	Caku 2023	2025		
<i>Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të riadhesuar dhe integrimit të të huajve</i>		<ul style="list-style-type: none"> Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional; Numri i rasteve të referuara tek autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur; 		40 %	70%	90%		
				40 %	75%	90%		

		• Kriteriumri i drejtorive komunale të ndërthitura me SMR					30 %	60 %	80 %
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mënyra	
2.1	Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal;	Koordino ndihmën dhe mbështetjen me drejtoritë relevante komunale, ne baza diore, për secilin rast; Realizo takime të rregullta dhe takime ad-hoc, diskuto rastet që kërkojnë zgjidhje;	Nr. i rasteve të referuara ne drejtoritë përkatëse komunale; Nr. i takimeve të rregullta dhe numri i rasteve të diskutuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB MAPL MFPT MSH MBPZHR QPS ZP	KA	Në vazhdimësi	S	
2.2	Profilizimi i të riadhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna;	Pranimi në zyrë i personave të riadhesuar apo të huaj; Intervista të riadhesuarin/të huajin, parashitro pyetje rreth nevojave dhe mundësi të	Nr. i personave të lajmëruar në ZKKK; Nr. i personave të intervistuar;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB ZP	KA	Në vazhdimësi	Raport DRPRIH ZKK SMF	

		tij/saj;	Nr. i personave me nevojat e vlerësuar;						
		Krijoi profilin e secilit person të kthyer apo te huaj;	Nr. i personave me profilin e vendosur ne SMR						
		Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj;							
		Vendos profilin dhe nevojat në SMR;							
2.3	Referimi i personave të riadhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre;	Refero personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve p.sh: Refero në ZGJC personat qe kanë nevojë për dokumentacion civil;	Nr. i personave të referuar në drejtoritë përkatëse;	ZKKK	DRPRIH ZP QPS QAP	KA	Në vazhdimësi	Raport DRPRI ZK SN	
		Refero personat e kthyer, apo të huaj në ZP që të regjistrohen si punëkërkuess;	Nr. i personave te referuar në QPS;						
		Refero personat e kthyer apo të huaj të cenushtëm në QPS;	Nr. i personave te referuar në DKA;						
		Refero në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmijë për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkollat;							

2.4	Përmirësimi i sistemit të kështillimit të personave të riadhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë;	Bazuar në profilin dhe nevojat, kështillo ata për mundësitë e përfuturit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integritit dhe të integritit;	Nr. i personave të kështilluar nga ZKKK Nr. i personave që janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP QAP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Ra DRPI Z
2.5	Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe kështillim të personave të riadhesuar dhe të huaj;	Vendos sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat; Njofto ata për pasojat ligjore të ri emigrimit; Kështillo për respektimin e afatave dhe detyrimet ligjore;	Takimet e rregullta me akterët relevant	ZKKK	DRPRIH Policia e Kosovës Shkollat ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatrat	/	Në vazhdimësi	Raport DRPRIH, ZKK Numri riadhesu dhe te hua identifik

	<p>informohesh nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marrë statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrimi, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj;</p> <p>Kontakti personin e kthyer apo të huajin informo për mundësitë e mbështetjes, refero në institucionet përkatëse;</p>	<p>dhe të huajve që identifikohen si rezultat i Zkëtij bashkëpunimi</p>		<p>vendore dhe ndërkombëtare me fokus rinteigrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë</p>			
<p>2.6</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit;</p>	<p>Realizo takime të rregullta në ZKKK;</p> <p>Diskutoni për referimin dhe koordinimin e rasteve;</p> <p>Analizo sistemin e referimit dhe koordinimit;</p> <p>Vlerëso gjendjen aktuale dhe Rekomando masa përmirësuese, në rast nevojë;</p>	<p>Nr. i takimeve të rregullta</p>	<p>ZKKK DRPRIH/MPB</p>	<p>ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rinteigrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë</p>	<p>/</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Raport monit</p>

2.7	Referimi i rasteve pas periudhes 12 mujore sipas legjislacionit në fuqi.	Identifikimi i personave / familjeve qe kane nevoje per mbeshtetje pas 12 muajve. Ndërmarrja e veprimeve për planifikim buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojshme pas 12 muajve.	Vizita personave / familjeve në skemën e akomodimit dhe me nevoja specifike pas periudhes 12 mujore	ZKKK QPS Drejtoritë përgjegjëse	DRPRIH ZP	/	Në vazhdimësi	Rap rrejt
Objekti i specifik 3		Indikatorët për majen e arritjes së objektivit		Baza	Caku 2023	2025		
<i>Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik</i>		<ul style="list-style-type: none"> • Numri i punëkërkesve të riadhesuar apo te huaj të profilituar dhe të kështilluar për zhvillimin në karrierë; • Numri i të riadhesuarve/huajve të punësuar; • Numri i përfjimeseve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës; • Numri i përfjimesve nga skemat e aftësimi profesional; • Numri i të riadhesuarve/ huajve përfjimes të grandeve bujqësore dhe kështillimeve në fushën e bujqësisë; • Numri i të riadhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore; 		60%	70%	90%		

		• Zgjerimi i fushave të aftësisimit profesional në përputhje me nevojat e regjës						
<i>%</i>	<i>Masat</i>	<i>Veprimet</i>	<i>Indikatorët</i>	<i>Institucioni përgjegjës</i>	<i>Institucioni /partneri përkratës</i>	<i>Kosto financiare</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Mje verifi</i>
3.1	Regjistrimi i të riadhesuarve/të huajve si punëkërkuës në Zyrat e Punësimit;	Prano në zyrë personin e riadhesuar/të huaj; Regjistro personat e riadhesuar/te huaj si punëkërkuës; Informo ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP;	Nr. i personave të riadhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkuës;	APRK ZP	DRPRIH/MPB ZKKK QAP Organizatet vendore dhe ndërkombëtare me fokus rritjen dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raport Rapo ZK
3.2	Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkuësve të riadhesuarve apo te të huajve;	Intervisto atë, parashiro pyetje rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj Krijë profilin e secilit person të kthyer apo të huaj Këshillo ata për orientim në karriera, bazuar në aftësitë dhe mundësitë e tyre	Numri i personave të riadhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj; Nr i dosjeve fizike të personave të riadhesuar apo te huaj që janë këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre janë evidentuar;	ZP	ZKKK QAP	/	Në vazhdimësi	Raport Numri i Shënim raportë SM

		Krijo një dosje për secilin person të riadhesuar apo te huaj	vendosur shënime për profilizim dhe këshillim në SMR							
3.3	Punësimi i të riadhesuarve apo te huajve përmes ndërmjetësimit në punësim;	Ndërmjetëso në punësim personat e riadhesuar apo ata te huaj të përgatitur për tregun e punës; Evidento të dhënat relevante në SMR;	Numri i rasteve të ndërmjetësuar Numri i rasteve të punësimit të riadhesuarve apo te te huajve me ndërmjetësim Të dhënat për ndërmjetësim dhe punësim në SMR	ZP	DRPRIH ZKKK APRK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë (donatorët)	/		Në vazhdimësi	Raport me të mbi n raste ndërmj dhe pur person riadhe atyre	
3.4	Trajnimi në punë dhe punësimi i të riadhesuarve apo te te huajve përmes subvencionimit të pagës;	Ndërmjetëso për trajnim përmes punës personat ne nevojë për përgatitjen për tregun e punës; Monitoro mbarëvajtjen e trajnimit dhe punësimit;	Numri i rasteve të ndërmjetësuarra për trajnim dhe përgatitje për tregun e punës; Numri i rasteve të monitoruara	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/		Në vazhdimësi	Raportet dhe QAF	
3.5	Verëpunësimi i të riadhesuarve apo te të huajve përmes financimit të planeve të biznesit;	Informo këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfundimit nga kjo skemë;	Numri i të riadhesuarve apo te te huajve që informohen për mundësitë dhe kushte e përfundimit përmes planeve të biznesit	ZP	DRPRIH ZKKK QAP Organizatat vendore dhe	/		Në vazhdimësi	Raport ZKK	

	kur thirria të jetë e hapur për aplikim; Ndihmo këta persona në kompletimin e dosjes për aplikim;			ndërkombëtare me fokus rrimtegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
3.6	Aftësimi profesional i personave të riadhesuar dhe te huajve në përpudhje me kërkesat e tregut të punës;	Identifiko personat e riadhesuar dhe te huaj që kanë nevojë për aftësim profesional; Identifiko profilin e tyre dhe orientoj ata ne profesionet adekuate me pritjet dhe dëshirat e tyre; Referoj ata në QAP përkatëse;	Numri i të riadhesuarve apo te huajve që vijojnë aftësimin profesional Numri i të riadhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar për AP Numri i të riadhesuarve apo te huajve që referohen në QAP	ZP QAP DRPRIH ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rrimtegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Bizneset	/	Në vazhdimësi	Raport me të riad dhe të l vij aftë profe
3.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);	Monitoro në baza të rregulltsharëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); Vlerëso ndikimin e tyre ne përgatitjen dhe ri integrimin e PR;	Numri i të riadhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ; Të dhëna për ndikimin e MATP në rrimtegrimin dhe integrimin e tyre	ZP DRPRIH/MPB (Kordinatori Rajonal) ZKKK APRK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rrimtegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raport period monitori vlerësi përgatit DRPRIH (Kordinator Rajonal)
3.8	Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe kështillimi i të	Informimi i keyre personave për mundësitë e përfitimt të granteve bujqësore;	Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituat grante bujqësore	Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/ Komuna ZKKK AZHBR/MBZHR Drejtoritë përkatëse komunale	/	Në vazhdimësi	Raport ZKKK i dhënat për kur përfit granteve person:

riatd	riatdhesuarve dhe te huajve në zonat rurale;	Përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve si përfites i granteve bujqësore;		Organizatet vendore dhe ndërkombëtare me fokus rintegrimim dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Baza	Caku 2023	2025
Objekti i specifik 4			Indikatorët për matjen e arritjes së objektit					
<i>Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjes sociale të personave të riatdhesuar dhe te huajve</i>			<p>Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;</p> <p>Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfites të asistencës sociale;</p> <p>Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevojë që kanë pranimin e trajtimit psiko-social;</p> <p>Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ;</p> <p>Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komuniteti (pas periudhës 12 mujore);</p> <p>Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfinuar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;</p>			40%	75%	91
				50%	70%	91		
				%	30%	56		
				10%	30%	60		
				10%	30%	50		
				30%	50%	60		
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afatet kohore	Mjetet verifik
4.1	Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për mundësitë e përfshirjes në skemat sociale;	Prano në zyre personin e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK;	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale;	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Kordinatori Rajonal) ZP Drejtoria e përkrahës komonale KKR	/	Në vazhdimësi	Raportet QP Raportet ZKK

	<p>skemat sociale;</p> <p>Këshilloje atë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale;</p> <p>Menaxho rastin deri ne vendosjen ne sistemin social;</p> <p>Regjistroi ne bazën e te dhënave (SNS) rastin/skenën e përfitim;</p>	<p>vendosen në sistemin social</p> <p>Vendosja e të dhënave për të riadhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR</p>		<p>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë</p>			
<p>4.2</p> <p>Asistimi i personave të riadhesuar dhe te huaj në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.</p>	<p>Të përfshihet zyra e gjendjes civile si pjesë e KKR-së (e preferueshme)</p> <p>Asisto personat e riadhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale si dhe ndihma juridike falas</p> <p>Menaxho dhe monitoro rastin në shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar;</p>	<p>Vendimi i KKR-së plotësuar dhe ndryshuar nga komuna</p> <p>Numri i personave të riadhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për aplikim në skemat sociale dhe ndihme juridike falas</p> <p>Numri i rasteve të monitoruara deri në shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar</p> <p>Vendosja e të dhënave për numrin e të riadhesuarve dhe te huajve që</p>	<p>Komuna KKR QPS</p>	<p>ZKKK DRPRIH/MPB (Kordinatori Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Aqensionit për ndihmë juridike falas</p>	<p>/</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Raport Q1 Raport ZKI</p>

